

KADASTRA FISKALE

BULETIN INFORMUES

Botimi 2


26 JANAR 2022

Përditësimi i Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale

Ekipi i IT-së së projektit ProTax dhe DPTP-ja po punojnë për të përmirësuar sistemin e Kadastrës Fiskale. Publikimi i sistemit të përditësuar është planifikuar të bëhet brenda muajit Shkurt. Në lidhje me këtë proces, do të zhvillohet një takim me datë 1 Shkurt ku bashkitë do të ftohen në një prezantim Demo të Sistemit.

Regjistri

Regjistri është pasuruar me informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK). Pas përditësimit, regjistri do të përfshijë njësitë e ndërtesave të ASHK-së dhe tokën. Gjithashtu, janë përmirësuar funksionalitetet e punës në regjistrë. Në figurën e mëposhtme është paraqitur baza e burimit të të dhënave mbi të cilën ndërtohet struktura e regjistrit të Kadastrës Fiskale.



TAKIMI I
RRADHËS!

SHKURT
1

PREZANTIM I
VERSIONIT TË
PËRDITËSUAR
TË SISTEMIT
INFORMATIK
TË
KADASTRËS
FISKALE PËR 9
BASHKITË
PILOT

Taksimi

Duke qenë se regjistri tani përfshin edhe tokën, funksionaliteti i taksimit po përmirësohet për të bërë të mundur taksimin e tokës bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”. Gjatë kësaj kohe po kryhen testime të njëpasnjëshme se kur do të mundësohet taksimi i parë i tokës. DPTP-ja do të informojë bashkitë për përgatitjet që duhen ndërmarrë në kuadër të taksimit të tokës.

Përmirësimi/Rritja e Sigurisë

Puna e kryer në sistem përfshin gjithashtu dhe përmirësimin dhe rritjen e sigurisë. Ky përmirësim synon një procedurë të re identifikimi e bazuar në vërtetimin autentik me 2 (dy) faktorë. Të gjitha llogaritë do të lidhen me një e-mail, që do të thotë se të gjithë përdoruesit duhet të regjistrohen me adresën e tyre të postës elektronike. Të gjithë përdoruesit do të marrin informacion dhe udhëzime të mëtejshme nga DPTP.

Përveç kësaj, në kuadër të ruajtjes së sigurisë dhe integritetit të informacionit, ne bëjmë rishikime të rregullta të aktivitetit të përdoruesve në sistemin e Kadastrës Fiskale. Kështu, përdoruesve të cilët nuk kanë konfirmuar angazhimin për punën në sistem dhe rezultojnë me mungesë aktiviteti u është bllokuar aksesimi dhe mund të riaktivizohet me kërkesë.

Takim i dedikuar prezantimit të versionit të përditësuar të sistemit

Në datën 1 Shkurt do të organizohet një takim online me fokus prezantimin e versionit të përditësuar të sistemit të Kadastrës Fiskale. Qëllimi i këtij takimi do të jetë demonstrimi në një mjedis trajnues i të gjitha funksionaliteteve të përditësuara të sistemit. Për shkak të nevojës së 9 bashkive pilot të angazhuara për të punuar sa më shpejt në këtë sistem, fokusi do të përqëndrohet kryesisht te ato. Megjithatë, ftesa është e hapur për të gjitha bashkitë që duan të bëhen pjesë.

Proçesi i verifikimit të Vendimeve të Këshillave Bashkiak

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP) udhëheq nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme si dhe monitoron dhe asiston njësitë e vetëqeverisjes vendore për procedurat e ndjekura në llogaritjen e bazës së taksueshme.

Në këtë kuadër, me datë **14 Janar** DPTP ka dërguar për 61 (gjashtëdhjetë e një) bashki kërkesën përmes email me subjekt “Mbi dërgimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë lidhur me taksën e pasurisë”.

Aktualisht janë analizuar 22 Vendime të Këshillave Bashkiak dhe është evidentuar që krahasimisht me vitet e kaluara po rritet numri Bashkive që janë në linjë me metodologjinë për taksën e ndërtesës. Pas procesit të analizimit dhe verifikimit të këtyre vendimeve, DPTP do të dërgojë në mënyrë shkresore komentet dhe sugjerimet për korrigjimet e mundshme për secilën bashki.



Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është **fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake**. Projekti synon administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut. Një sistem i qendëruar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

ProTax Albania financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim.



Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr.3,
Tiranë



Alvaro.Bulku@financa.gov.al
Klaudia.Vukzaj@financa.gov.al
Valmira.Fejza@financa.gov.al
Eva.Hasa@financa.gov.al



<https://dptp.financa.gov.al>